

RELACIONI

Kompleksiteti dhe sfidat që lidhen me regjistrimin e lindjeve janë përkeqësuar për rastet e fëmijëve të lindur jashtë vendit, veçanërisht për fëmijët prindërit e të cilëve jetojnë jashtë vendit në mënyrë të parregullt. Shpesh këta prindër nuk mund të sigurojnë akte të rregullta të lindjes ose marrin vetëm një njoftim lindjeje që nuk përfshin informacionin bazë (përfshirë emrin) të kërkuar nga autoritetet shqiptare për të regjistruar lindjen e tyre.

Sipas procedurës aktuale ligjore për të regjistruar një fëmijë të lindur jashtë vendit, prindërit duhet të marrin një certifikatë lindjeje nga vendi i lindjes dhe ajo duhet të jetë në formën e parashikuar nga ligji, të jetë akt i legalizuar, i përkthyer në shqip dhe i notëruar. Ky dokument duhet të verifikohet nga Ministria e Jashtme dhe Ministria e Brendshme e vendit të huaj ose nga bashkë (se verifikimi mund të ndryshojë nga një vend në tjetrin). Pasi përfundimit të këtyre procedurave, fëmija regjistrohet në zyrën e gjendjes civile në Shqipëri.

Kërkesat burokratike të kësaj procedure janë të tatueshme dhe shpesh të pamundura për t'u përmbushur, veçanërisht për nënat pa dokumenta që lindin në vende të huaja dhe që jetojnë në kushte varfërie dhe vulnerabiliteti.

Shumë prindër nuk arrijnë të trajtojnë të gjitha pengesat burokratike të lidhura me legalizimin e certifikatave të lindjes në vend të huaj dhe kthehen ose deportohen në Shqipëri para se të marrin një certifikatë në formën e kërkuar nga autoritetet shqiptare. Në raste të tilla, certifikatat nuk legalizohen dhe lindjet e fëmijëve nuk janë të regjistruara në Shqipëri pavarësisht nëse prindërit janë shqiptarë. Nga ana tjetër kjo kategori prindëresh në shumicën dërrmuese nuk është në gjendje të kthehet në vendin ku kanë lindur fëmijët për të zgjidhur çështjen, kështu që fëmijët e tyre janë pa identitet dhe në rrezik pashtetësie.

Sipas një marrëveshjeje të Nentorit të vitit 2011 midis një organizate jo fitimprurëse me fokus të veprimtarisë të saj pikërisht këtë fushë – TLAS¹ - dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë, TLAS njofton Ministrinë e Jashtme për rastet e qytetarëve të cilët kërkojnë legalizimin e dokumenteve të tyre, por që nuk kanë mjete ekonomike ose fizike për ta kryer vetë këtë proces. Ky ishte dhe është një shërbim ligjor falas i ofruar nga TLAS, mbështetur nga UNICEF dhe UNHCR që i ka shërbyer për shumë vite mijëra përfituesve vulnerabel, të cilët përndryshe do të mbeteshin në rrezik të pashtetësisë.

¹ Shërbimi Ligjor Falas Tiranë, Tirana Legal Aid Service, TLAS

Ky ishte një shërbim që me shtetin Grek, nga ku janë dhe prurjet më të shumta vijoi normalisht të ushtrohej deri në 19 Korrik 2016, sepse pas kësaj date autoritetet e shtetit Grek refuzuan vijimin e këtij bashkëpunimi.

Për të paraqitur një statistikë, vetëm gjatë 2017, TLAS trajtoi me ndihme juridike 631 raste të regjistrimit të lindjeve, nga të cilët 380 të lindur në Greqi nga të cilët 62 % e tyre ishin të komunitetit Romë, ndërkohë që ka identifikuar 300 raste të tjera që nuk mund të zgjidhen as me procedura administrative dhe as përmes gjykatës. Nisur nga kjo situatë TLAS me mbështetje të UNHCR realizoi Studimin “Hartëzimi i personave pa shtetësi në Shqipëri”² për periudhën Shtator- Dhjetor 2017. Rezultoi që u identifikuan edhe 1031 persona të tjerë pashtetësi nga të cilët 96.7 % janë fëmijë, dhe që 84% e tyre ndeshin pengesa për marrjen e shtetësisë për shkak të procedurave të regjistrimit të lindjes. Studimi i identifikoi të 1031 personat me emra, moshë, gjini dhe adresa, dhe ata janë në pritje për t’u zgjidhur por pengesat janë të mëdha (autoritetet Greke në vecanti refuzojnë të lëshojnë një çertifikatë të plotë të lindjes, për ata që jetojnë në mënyrë të parregullt, ose e lëshojnë atë me të meta në rubrikat përkatëse);

Aktualisht Aktet e lindjes të lëshuara nga autoritete e huaja të cilat janë të paplota ose kanë pasaktësi të elementëve të tyre, shpesh refuzohen të njihen nga autoritetet vendase dhe madje edhe gjykata shqiptare duke vendosur që përderia akti ekziston dhe ai është me të meta ato duhet të rregullohen në shtetin që e ka lëshuar atë.

Dështimi i Shqipërisë për të trajtuar këto çështje përbën mospajtueshmëri me detyrimet e saj ndërkombëtare, së pari me Konventën për të Drejtat e Fëmijës. Si pasojë, pashtetësia dhe rreziku i pashtetësisë është një problem serioz³ dhe real me të cilin përballen me qindra qytetarë (veçanërisht romët, por pa u kufizuar vetëm tek ata).

Ky projektligj synon pikërisht të rregullojë në mënyrë përfundimtare këtë gjëndje të krijuar duke i dhënë fund kalvarit të gjatë të përpjekjeve të shtetasve dhe aktorëve të përfshirë në këtë process zgjidhjeje. Projektligji parashikon:

- Në rastet kur akti i lindjes i hartuar në një shtet tjetër ka të dhëna të paplota ose të pasakta, është kompetencë e gjykatës shqiptare të bëjë vërtetimin e faktit juridik të lindjes me qëllim rregjistrimin në zyrat e gjendjes civile.

Kërkesa shqyrtohet nga gjykata e rrethit gjyqësor në të cilin kanë vendbanimin prindi ose prindërit e fëmijës për të cilin kërkohet regjistrimi. Gjykata vendos shqyrtimin e kërkesës për vërtetimin e faktit juridik të lindjes brenda 45 ditëve nga data e depozitimit të kërkesës duke thirrur me cilësinë e personit të interesuar zyrën e gjendjes civile. Nëse ndaj vendimit të gjykatës së shkallës

² Studimi “Hartëzimi i Personave pa Shtetësi në Shqipëri” dhe “Romët Përkasin” gjenden në link:

<http://tlas.org.al/sq/studime>

³Përvec Studimit më sipër Programi Sokrates që funksionon në sistemin parauniversitar të arsimit ka evidentuar 1130 fëmijë të regjistruar në sistemin arsimor që nuk kanë numër identiteti, Nga ky numër, 995 fëmijë nuk u gjenden në Regjistrin Civil dhe as në listën që evidentoi Studimi i Pashtetësisë.

së parë ushtrohet ankimi, gjykata e apelit shqyrton ankimin, në dhomë këshillimi, brenda 30 ditësh nga data e depozitimit të tij.

- Për aspektin e lindjeve brenda vendit, propozimet e bera për ndryshimin e nenit 40 & 41, i japin perfundimisht zgjidhje edhe rasteve të fëmijëve të lindur në një institucion shëndetësor brenda Republikës së Shqipërisë dhe nuk deklarohen/regjistrohen në zyrat e gjendjes civile. Në këtë aspekt marrin përsipër rol njësitë për mbrojtjen e fëmijës si dhe përcaktohet edhe procedura që ndiqet në këto raste.

- Projektligji parashikon se për fëmijët e lindur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nga shtetas shqiptar me banim të përhershëm në Shqipëri, rregjistrimi i lindjes së fëmijës bëhet në shërbimin e gjendjes civile të atij vendi. Kur kjo është e pamundur rregjistrimi i lindjes mund të behet në përfaqësitë diplomatike ose konsullore shqiptare në vendin ku ka ndodhur lindja.

-Kur në aktin e lindjes të mbajtur jashtë vendit është e paplotësuar rubrika e emrit të fëmijës, plotësimi i saj bëhet në përputhje me *procedurën administrative, të përcaktuar me akt nënligjor të Ministrit përgjegjës për gjendjen civile.*

- Të gjitha subjektet shëndetësore, shtetërore dhe private, që kanë të drejtë të vërtetojnë lindjen, janë të detyruara, që për çdo lindje të dërgojnë në zyrat e gjendjes civile, ku prindërit kanë vendbanimin, dokumentacionin për lindjet e ndodhura pranë institucioneve të tyre. Modalitetet, lloji i dokumentacionit, forma dhe mënyra e komunikimit ndërmjet këtyre institucioneve përcaktohet me udhëzim të përbashkët të Ministrave përkatës që mbulojnë institucionet e lartpërmendura.

-Për lindjet e raportuara sipas pikës 1 të nenit 41/1, zyra përkatëse e gjendjes civile plotëson një regjistër të përkohshëm. Ministri përgjegjës për gjendjen civile, përcakton me udhëzim rregulla të hollësishme për administrimin e regjistrit të përkohshëm të lindjeve të raportuara. Nëse rregjistrimi i lindjes së fëmijës, nuk kryhet brenda 60 ditëve, nëpunësi i gjendjes civile informon njësinë për mbrojtjen e fëmijës pranë njësisë vendore, e cila ndërmerr veprimet konkrete për vlerësimin e situatës dhe deklarimin në zyrën e gjendjes civile.

-Në teorinë e së drejtës shpesh herë rregjistrimi në zyrat e gjendjes civile konsiderohet si “e drejta për të pasur të drejta”, dhe kjo për arsyen e thjeshtë sepse pas rregjistrimit në gjendjen civile shtetasit, dhe në vecanti fëmijët, gëzojnë dhe zhvillojnë një sërë të drejtash të tjera si e drejta për arsim, për përkujdesje shëndetësore, përkujdesje shoqërore, strehim, akses në shërbime, etj.

-Projektligji synon t'i japë fund një vakumi ligjor që i vendoste shtetasit shqiptarë, vecanërisht ata që i përkasin komuniteteve më vulnerabël, në pozitën më të vështirë të mundshme e vërtetuar edhe nga eksperiencia 20 vjeçare e TLAS si një ofrues i shërbimeve ligjore falas për individët vulnerabël të parregjistruar në zyrat e gjendjes civile. Nëpërmjet formulimeve të tij projektligji

mundësohen rrugë procedurale që fenomene të tilla jo vetëm të mos eksiztojnë më, por edhe nëse ato janë aktualisht të pazgjidhura apo shfaqen në të ardhmen të rregullohen nëpërmjet rrugëve administrative të shpejta dhe efikase dhe/ose nëpërmjet procedurës së shpejtë gjyqësore.

-Që nga qershori i vitit 2014, Republika e Shqipërisë është kandidatë zyrtare për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Ky status është i kushtëzuar nga zbatimi i reformave strukturore kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Në këtë kontekst, Qeveria Shqiptare është angazhuar të ndërmarrë reforma të thella drejt pesë prioritetëve kryesorë; (i) një trupë profesionale dhe të depolitizuar të nëpunësve civilë, (ii) një sistem gjyqësor më të pavarur, (iii) luftë kundër korrupsionit, (iv) luftë kundër krimit të organizuar, dhe (v) mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Në prioritetin e pestë, Qeveria ka përcaktuar si një qëllim afatshkurtër zbatimin e planit kombëtar për integrimin e romëve, duke u përqendruar, ndër të tjera, në regjistrimin civil dhe aksesin në drejtësi, arsim, kujdes shëndetësor dhe të drejtën për strehim.

Ky projektligj hartohet dhe zbaton në praktikë pikërisht prioritetin e pestë dhe jo vetëm për këtë kategori.